

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vuçiç largohet nga Presidenca, por synon të rikthehet si Kryeministër i Serbisë
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/vucic-largohet-nga-presidenca-por-synon-te-rikthehet-si-kryeminister-i-serbise/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 06:25:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 06:24:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	728f97ca51eb3b9f4e2c6361c9cdd9f4e59d750454427d159e0bcd1e303fd4f7
TEKSTI	e38ffcc8daedf2f296a6e5d1817c6767d5d6807908fb099cd4e9395288b44839
PAMJA	e7630f772a09ac3265689843ea289a98532b087d4b1acd1f71844ae785638d5e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2025af47756dcb7bffa650f0c17ab412bf35e9460094495552b60b63b1c267
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	07dcd14af433ca62f57d8764b5c6075704d5b7e87042b539795708e53d505cef
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2025af47756dcb7bffa650f0c17ab412bf35e9460094495552b60b63b1c267>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Vuçiç largohet nga Presidenca, por synon të rikthehet si Kryeministër i Serbisë

AKTUALITET BOTA KRYESORE E MARTË, 15 SHTATOR 2026 08:24



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka njoftuar se më 27 shtator 2026 do të japë dorëheqjen nga posti që mban prej vitit 2017.

Gjatë një interviste për televizionin "Pink", Vuçiç deklaroi se mbrëmjen e 27 shtatorit do t'u drejtohet qytetarëve serbë për t'i falënderuar për mbështetjen që i kanë dhënë gjatë viteve të tij në detyrë.



"Dua t'ju njoftoj se më 27 shtator do të jap dorëheqjen nga posti i presidentit. Atë mbrëmje do t'u drejtohem qytetarëve dhe do t'i falënderoj për mbështetjen", deklaroi ai.



Vuçiç tha se i ka shërbyer Serbisë dhe qytetarëve të saj me përkushtim, duke nënvizuar se është presidenti që ka qëndruar më gjatë në këtë detyrë që prej vendosjes së sistemit shumëpartiak.

Dorëheqja, megjithatë, nuk pritet të shënojë largimin e tij nga politika. Partia Progresive Serbe e ka propozuar që Vuçiç të udhëheqë listën zgjedhore dhe të synojë postin e Kryeministrit pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 25 tetorit. Reuters dhe Associated Press raportojnë se ai synon të rikthehet në krye të pushtetit ekzekutiv.

Pak ditë më parë, Vuçiç firmosi dekretin për shpërndarjen e Parlamentit dhe caktoi 25 tetorin si datën e zgjedhjeve të parakohshme, më shumë se një vit përpara përfundimit normal të mandatit. Reuters konfirmoi shpërndarjen e Parlamentit dhe thirrjen e zgjedhjeve.

Gjatë intervistës, Vuçiç foli edhe për protestat studentore dhe Listën Studentore, duke pretenduar se pas saj qëndrojnë ish-drejtuës të Partisë Demokratike, mes tyre Bojan Pajtić dhe Dushan Petrović.

LAJMET KRYESORE



Me 16 shtator parashikohet mbi 1 milionë qytetarë në Prishtinë. Pritet vendimi i Hagës. Ka dyshime për trazira nëse....



Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin, në 17 shtator mbaron episodi i tensionuar



Tërhiqet Bekim Sejdiu, dështon kandidatura për President: Nuk ka mbështetje të mjaftueshme parlamentare



Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie



Mos i përdorni fëmijet e shkollave për mitingje dhe luftë politike!

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

Ai përsëri gjykasni pretendimin se raportimet për përdorimin e një topi zanor gjatë protestës së 15 marsit 2025 në Beograd ishin të sajura dhe se regjistrimi audio ishte manipuluar.

Presidenti serb akuzoi edhe faktorë të jashtëm se kanë tentuar të organizojnë një "revolucion" në Serbi, me synimin, sipas tij, për të thelluar ndarjet shoqërore dhe për të destabilizuar vendin.

Dorëheqja vjen në një nga periudhat më të tensionuara të sundimit të Vuçiçit. Protestat studentore, të nisura pas tragjedisë së Novi Sadit, janë shndërruar në sfidën më serioze ndaj pushtetit të tij shumëvjeçar.

Tashmë përballja do të zhvendoset nga rruga në kutitë e votimit: nga njëra anë Vuçiç dhe Partia Progresive Serbe, ndërsa nga ana tjetër studentët dhe forcat opozitare që kërkojnë ndryshimin e sistemit.

Dorëheqja e Aleksandar Vuçiçit nga posti i Presidentit të Serbisë mund të duket, në pamje të parë, si fundi i një epoke politike. Por në të vërtetë nuk është largim. Është një manovër për të ruajtur pushtetin.

Vuçiç nuk po ikën nga politika. Ai po lë Presidencën për të kërkuar postin e Kryeministrit, aty ku ndodhet pushteti i drejtpërdrejtë ekzekutiv. Pra, ai nuk po heq dorë nga drejtimi i Serbisë; po përpiqet të ndryshojë karrigen nga e cila do ta drejtojë atë.

Pas më shumë se një dekadë në qendër të pushtetit, Vuçiç e kupton se sistemi që ka ndërtuar po përballët me sfidën më serioze. Protestat studentore nuk janë më një shpërthim i përkohshëm. Ato janë kthyer në një lëvizje politike që kërkon të hyjë në Parlament dhe të ndryshojë raportet e forcave në Serbi.

Thirrja e zgjedhjeve të parakohshme për 25 tetor është një bast i madh. Vuçiç kërkon t'i kapë kundërshtarët të papërgatitur, të përdorë strukturën e fuqishme të partisë së tij dhe ta shndërrojë garën në një referendum personal: Vuçiç ose kaos.

Kjo ka qenë formula e tij politike prej vitesh. Çdo protestë paraqitet si komplot i huaj, çdo kundërshtar si rrezik për shtetin dhe çdo kritikë si përpjekje për destabilizimin e Serbisë.

Por kësaj here përballë tij nuk ndodhen vetëm partitë tradicionale të opozitës. Janë studentët, profesorët, profesionistët dhe një brez i ri që nuk ka përsë të mbajë mbi shpinë marrëveshjet dhe konfliktet e politikës së vjetër.

Vuçiç kërkon të largohet nga Presidenca si "shërbëtori më jetëgjatë i Serbisë" dhe të rikthehet menjëherë si Kryeministër. Kjo tregon se dorëheqja nuk është sakrificë dhe as tërheqje. Është riciklim politik.

Pyetja vendimtare është nëse qytetarët serbë do ta pranojnë këtë ndërrim karrigesh, apo më 25 tetor do të vendosin se pas kaq shumë vitesh Serbia ka nevojë jo për ndryshimin e zyrës së Vuçiçit, por për ndryshimin e vetë pushtetit.

Më 27 shtator Vuçiç do të largohet nga Presidenca. Por beteja e tij e vërtetë për të mos u larguar nga pushteti sapo ka filluar.

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Në burg apo i lirë? Avokati Ndreca për vendimin e së martës: S'ka jus...



U godit nga policia, protestuesi nga Diaspora: Të bashkohemi për rrëz...



Credins bank sjell Visa Infinite, kartën e parë metalike në Shqipëri!



Bardhi: Rama po bën gjithçka për të ndikuar trupin gjykues për të nxj...



Efektivi goditi qytetarin/ Balla: Policia bëri detyrën, perimetri i s...

LAJMET E FUNDIT





Në burg apo i lirë? Avokati Ndreca për vendimin e së martës: S'ka justifikim ligjor për ta mbajtur në qeli

10 ORË E 34 MINUTA MË PARË



Ndahet nga jeta nënkolonel Alfons Qorllari, ministri Nufi: La gjurmë në formimin e brezave të ushtarakëve

10 ORË E 40 MINUTA MË PARË



Haga vendos më 16 shtator, Rutte: KFOR do të qëndrojë në Kosovë pavarësisht vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

10 ORË E 45 MINUTA MË PARË



Filip Çakuli: Veliain e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

10 ORË E 52 MINUTA MË PARË



Seferi nuk ndalet në Turqi, dopietë dhe një mesazh i fortë për Kombëtaren

10 ORË E 55 MINUTA MË PARË



Nga arrestimi te vendimi, kalvari sesi ka shkuar në 6 vite procesi në Hagë

11 ORË E 7 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: **Nikoll LESI**

KRYEREDAKTOR: **Daniel MUÇAKU**

ZV/KRYEREDAKTOR: **Redjon SHTYLLA**

BORDI: **Elsa KAMBERI, KRYETARE**

NIPT: **J71425013C**



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.